



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD

Data 27/08/2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemim asfaltim i rruges Mirake - Plane , Mirake-Katund
faza e I-re njesia Administrative Polis Bashkia Librazhd.**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punime shtrimi dhe asfaltimi-
45233222-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 000 000 (shtatedhjetë e pesë milion)leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

A. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë :

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit që prokurohet**.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2022, 2023, 2024**) , lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vite të periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - 2. *Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore*
 - 3. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - 4. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - 5. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
 - 6. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës*
 - 7. *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - 2. *Situacionin përfundimtar të objektit*
 - 3. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
 - 4. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - 5. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
 - 6. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës*

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me

përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.1 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.P-1 (Punime germimi e toke)* **Niveli B**
 - *N.P-3 (Rikonstrukcion dhe mirembajtje,)* **Niveli B**
 - *N.P-4 (Rruge, autostrada, mbikalime,)* **Niveli B**
 - *N.P-5 (Punime nentokesore, ura vepra,)* **Niveli B**
 - *N.P-12 (Punime të inxhinjerise se mjedisit)* **Niveli B**
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - *N.S.-1 (Punime për prishjen e ndertimeve)* **Niveli B**
 - *N.S.-4 (Punime të muratues,)* **Niveli B**
 - *N.S.-6 (sinjalistika rrugore jo ndricuese)* **Niveli B**

- **N.S.-9** (Punime strukturore speciale ,) **Niveli B**
- **N.S.-10** (Shtresa dhe mbistruktura infrast,) **Niveli B**
- **N.S.-18** (Punime topogjeodezike,) **Niveli B**
- **N.S.-20** (Shpime gjeologo-inxhinier,) **Niveli B**
sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë te përcaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

2.3.4 Staf i kryesor dhe mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se

kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime Germimi dhe Prishje, punimet për nenshtrasat rrugore , shtresat asfaltike sipas kuotave të dhëna nga inxhinierët)</i>
<i>1 (nje)Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Ne preventivin fillestar përcaktohen volume konkrete pune të domosdoshme për të ndjekur nga inxhinieri hidroteknik përse i përket volumit të përgjithshëm të parashikuar në preventiv</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për punimet për profilat terthore duke dhënë përfundimet sipas kushteve të zbatimit</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Mjedisi</i>	<i>Kërkohet inxhinier mjedisi pasi kemi të bëjmë me punime germimi, ndërtimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e</i>

	inerte te cilat paraqesin rrezikshmeri per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale, prandaj asistenca e nje inxhinieri mjedisi do te jete e domosdoshme.
--	--

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

Lloji i Specialistit	Numri i kerkuar
• Teknik Ndertimi	1
• Teknik Topograf/Gjeodet	1
• Specialist per punime ne ruge dhe asfalti	3
• Murator	4
• Karpentier	2
• Hekurkthyes	3
• Betonues	1
• Saldator	1
• Specialist ndertimi	2
• Hidraulik	2
• Bojaxhi	2
• Gurepunues/Guregdhendes	1

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				

2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmhtë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme janë vendosur në zbatim të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datw 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nëni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- a) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin,
(Për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit si dhe të rezultojë në

listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

- b) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Specialist Per Testimin e Performances se Materialeve/Produkteve te Ndertimit /Inxhinier Materialesh**,
(Për specialistin e mesiperm duhen paraqitur çertifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).
- c) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i certifikuar si **Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis**,
(Për ekspertin e Mjedisit çertifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).
- d) **1(nje)** person, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për **"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"**, **"Pergjegjes per sigurine"**, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- e) Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, **1(nje)** persona te certifikuar per **"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"**, te cilet duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit).
- f) Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij **4 (kater)** persona specialist te certifikuar per **"Punime ne lartesi"**, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.
- g) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1(nje)** mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje (konform ligjit per cdo kompani me mbi 15 punetore). Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentimi: Sipas pikës 2.3.7, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për

vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **60 (gjashtedhjetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatese në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës, afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)**
- **ISO 14001:2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)**
- **ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë)**

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me perkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(një pike pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	1 copë	Pronësi ose me qera

Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njezete) ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri teknologjike (trancher) per frezim dhe hapje kanali me thellesi mbi 50 cm ne rruge te asfaltuara / Bobcat	1 copë	Pronësi ose me qera
Telehender/Pirun	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
RTV Rimorkiator ose Karrotrec	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues (ngjeshes)	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtuese	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice me goma (ose mobile)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri/Pajisje vijezi	1 copë	Pronësi ose me qera
Skarifikes Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerese sharre Asfalti/Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik Hidraulik/Pneumatik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni (te brendshem)	4 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karb. ose elekt., per ngjeshje	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese shtresash	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	4 copë	Pronësi ose me qera
Kontener Stacioner (zyre ne objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Prozektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
GPS per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Total Station per rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni , pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
Nyje Inertesh , pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi

Fabrike Asfalti pajisur me leje mjedisore nga QKL / ose mobile e levizeshme	1 copë	Pronësi ose me qera ose me kontrate/marreveshje furnizimi/bashkepunimi
---	--------	--

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 60cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).*
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.*
- f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

NJESIA E PROKURIMIT